

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Habib Zeqiri, me procesmbajtësen Minire Krasniqi, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, të cilën e përfaqëson me autorizim D.H, kundër të paditurit H.H, në çështjen juridike rimbursim dëmi, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 15 janar 2019, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesë padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë rr. "Lidhja e Pejës", si e bazuar,

II. DETYROHET i padituri **H.D** nga Shtimja rr., që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguajë shumën prej 208 € (dyqind e tetë euro) me kamatë ligjore, si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar nga dita e paraqitjes së padisë datë 15.10.2018, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 € (njëzetë euro) të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Më datë 15 tetor 2018, paditësi BKS në këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurit H.D për rimbursimin e dëmit lidhur me aksidentin e datës 24.12.2013.

Lidhur me këtë, gjykata ka caktuar seancën gjyqësor më datë 03 janar 2019, e që seanca nuk është mbajtur pasi që palët kanë kërkuar që seanca të shtyhet për një datë tjetër me arsyetimin, për sqarimin e përgjegjësisë së të paditurit dhe eventualisht pas kësaj të arrihet marrëveshje mes tyre. Gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit, me arsyetimin se arritje eventuale e ujdësië mes palëve, përbën vendimin më të qëlluar dhe me të pranueshëm, duke e caktuar seancën e radhës për datën 15 janar 2018, në të cilën nuk ka prezantuar i padituri.

Përfaqësuesi i paditëses ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës që ta aprovon kërkesëpadinë si të bazuar, dhe njëkohësisht ta obligon të paditurin që në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguaj paditësit shumën të cekur si në padi.

Shpenzimet e procedurës kontestimore, i ka kërkuar.

Ashtu siç është konstatua më lartë i padituri nuk ka qenë prezentë në seancën gjyqësore, edhe pse i njëjti sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 03 janar 2019 ka qenë i njoftuar me datën e mbajtjes së seancës, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar. Andaj gjykata me propozimin e përfaqësueses së paditëses sipas aktvendimit procedural ka vendosur që seanca gjyqësore të mbahet pa praninë e të paditurit.

Gjykata këtë aktvendim (që ka të bëjë me mbajtjen e seancës pa praninë e të paditurit) e ka bazuar në dispozitën e nenit 423 par.4, në të cilën përcaktohet se, nëse i padituri që është thirrur me rregull nuk vjen në seancën gjyqësore, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes mbahet pa praninë e tij.

Gjykata, për këtë çështje nuk ka caktuar seancë përgaditore, por drejtpërdrejt ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, edhe pse në parim seancë përgaditore është e detyrueshme. Neni 401 i LPK-së-së, parasheh *''Seanca përgaditore është e detyrueshme, përveçse në rastet në të cilat gjykata.....nga shkaku i pandërlikueshmërisë së kontestit vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgaditore''*.

Bazuar në faktin se kjo çështje është udhëhequr sipas dispozitave që kanë të bëjnë me kontestet me vlerë të vogël, pastaj themelësia e qartë e kërkesëpadisë sipas provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se çështja nuk rezulton të jetë e komplikuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike, gjykata ka vazhduar me administrimin e provave dhe atë, janë lexuar: Raporti Policori aksidentit nr.2013-AU-0425 i datës 24.12.2013, konfirmimi i polises siguruese i datës 30.06.2015, Ujdia jashtëgjyësore me nr.752/15 e datës 21.12.2015, urdhër transferi bankar i datës 21.09.2015 dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Divizioni për Kundërvajtje me nr.të lëndës 6004/15 të datës 27.05.2015.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat e administruara dhe atë: nga raporti policor 24.12.2013 dhe si rrjedhojë nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Divizioni për Kundërvajtje në të cilën i padituri është shpallur përgjegjës për veprën kundërvajtëse nga neni 62 par.4 dhe 352 par.1 të LSKRR-së.

Sa i përket dëmeve materiale, Byroja Kosovare e Sigurimit, duke vepruar konform Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia Nr.04/1-018, fillimisht më datë 10.09.2015, me të dëmtuarin M.S nga Prizreni, ka lidhur ujdj jashtëgjyësore, me ç'rast të dëmtuarit është kompensuar në emër të zhdëmtimit në lartësi prej 208 € (dyqind e tetë euro) sipas rregullave të brendshme të paditësit.¹

¹ Në shkresat e lëndës gjindet edhe urdhërtransferi banka i datës 21.09.2016, me të ciën është bërë tranferi i mjeteve financiare të dëmtuarit, në emër të dëmit material.

Lidhur me bazën juridike rreth themelësisë së kërkesëpadisë së paditësit, Gjykata ka gjetur se e njëjta bazohet në Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autpërgjegjësia Nr.04/L-018, dhe atë fillimisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1, në të cilën parashihet e drejta e personit të dëmtuar ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. Në ndërlidhje më këtë e drejta e Byrosë (BKS-së) për rimbursimin e dëmit rrjedh nga i njëjti nen paragrafi 4, në të cilën përcaktohet *‘‘Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat’’*.

Rrjedhimisht, bazuar në këto argumente (sa i përket gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës material) Gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe për të njëjtën e ka obliguar të paditurin ta bëjë rimbursimin e dëmit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, ashtu siç është urdhëruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit paditëses ja ka njohur të drejtën në kamatës ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vite pa destinim të caktuar ashti siç e ka kërkuar nga dita e paraqitjes së padisë dt.17.10.2018 deri në pagesën definitivie.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri është obliguar të paguaj shumën prej 20 €.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.992/18 me datën 15 janar 2019

Gjyqtari,
Habib Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.